



REPUBLIKA E KOSOVËS – REPUBLIKA KOSOVO
KOMUNA E VUSHTRRISE-OPŠTINA VUČITRA

01 Nr. / Br. 111/23

Nr. i fq. / Br. s: -1-

Data / Datum: 15.05.2023

VUSHTRRI - VUČITRA



REPUBLIKA E KOSOVËS

KUVENDI I KOMUNËS-VUSHTRRI

Në bazë të nenit 43.1 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, nenit 28.1 të Statutit 01.Nr-209/22 të Komunës së Vushtrrisë dhe nenit 6.3 të Rregullores për Punën e Kuvendit të Komunës dhe Organeve të Tij, Kryesuesja e Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë:

Ju fton

Të merrni pjesë në mbledhjen e Kuvendit të Komunës, e cila do të mbahet më datë **25 maj 2023 (e enjte) me fillim në ora 10:00**. Mbledhja do të mbahet në sallën e Kuvendit të Komunës në Vushtri.

Për këtë mbledhje propozohet ky:


R E N D I T E

1. Shqyrtimi dhe aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e rregullt e Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë, mbajtur më datë 27 prill 2023;
2. Shqyrtimi dhe aprovimi i Propozim- vendimit për ndarjen e dekoratave dhe mirënjohjeve për “Ditën e Çlirimit”;
3. Shqyrtimi dhe aprovimi i Draft – Rregullores për Punën e Komiteteve dhe Komisioneve të Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë;
4. Shqyrtimi i Informatës lidhur me gjendjen dhe mbrojtjen e pyjeve në Komunën e Vushtrrisë për vitin 2022;
5. Shqyrtimi i Propozim-vendimit për kompensimin të anëtarëve të Komisionit për verifikimin e procesit të dhënies në shfrytëzimin të pronës komunale;
6. Të ndryshme.

Melihate Basholli-Latifi



Kryesuese e Kuvendit të Komunës



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA

KOMUNA VUSHTRRI
OPŠTINA VUČITRN

PËR:	Kuvendin e komunës
NGA:	Melihate Basholli Latifi Kryesuese e Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë
TEMA:	Rekomandimet e Komitetit për Politikë dhe Financa, nga mbledhja e datës 15.5.2023

Në mbështetje të nenit 52, paragrafit 2 të Ligjit nr.03/L-40 për Vetëqeverisjen Lokale, nenit 37, paragrafit 4 të Statutit të Komunës, Komiteti për Politikë dhe Financa në mbledhjen e mbajtur më 15 maj 2023 ka shqyrtuar këto materiale dhe nxori këto rekomandime:

1. Shqyrtimi i Propozim- vendimit për ndarjen e dekoratave dhe mirënjohjeve për “Ditën e Çlirimit”.

Nga KPF-ja u propozua që të futet në listën e mirënjohjeve për kuvend:

- *Rifat Shaqiri – punëtor shëndetësor në transfuzionin e gjakut, ish – pjesëtar i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.*

Për këtë pikë të rendit të ditës , KPF-ja rekomandoi që të procedohet për kuvend të komunës në mbledhjen e radhës për shqyrtim.

2. Shqyrtimi i Draft – Rregullores për Punën e Komiteteve dhe Komisioneve të Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë.

Për këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja rekomandoi:

Që të procedohet për kuvend të komunës në mbledhjen e radhës për shqyrtim.

Lidhur me këtë, KPF-ja rekomandoi që të përgatitet një propozim – vendim për kompensim të anëtarëve të komisionit për verifikimin e procesit të dhënies në shfrytëzim të pronës komunale dhe të procedohet për kuvend komunës në mbledhjen e radhës për shqyrtim.

3. Shqyrtimi i kërkesës për dhënie në shfrytëzim të pronës komunale për nevojat e Spitalit të Përgjithshëm “Sheikh Zayed” në Vushtrri.

Për këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja rekomandoi:

Që të mos procedohet për kuvend të komunës në mbledhjen e radhës për shqyrtim, por t’i kthehet Kryetarit të Komunës për ta analizuar edhe më tutje (për shkak se komuna ka nevojë për prona), me qëllim që të takohet me Kryeministrin e Republikës së Kosovës, ministrin e Shëndetësisë, ministren e Drejtësisë që një pjesë e pronave të AKP-së t’iu kthehen komunës ose t’i merr në shfrytëzim këto prona.

4. Shqyrtimi i Informatës lidhur me gjendjen dhe mbrojtjen e pyjeve në Komunën e Vushtrrisë për vitin 2022.

Për këtë pikë të rendit të ditës:

Që të procedohet për kuvend të komunës në mbledhjen e radhës për shqyrtim.

Me respekt!



REPUBLIKA E KOSOVËS



KUVENDI I KOMUNËS-VUSHTRRI

PROCESVERBAL
NGA MBLEDHJA E -IV- E RREGULLT E KUVENDIT TË KOMUNËS SË
VUSHTRRISË, MBAJTUR MË 27 PRILL 2023

Mbledhja është mbajtur në sallën e Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë, duke filluar në orën 10:15. Në këtë mbledhje ishin të pranishëm anëtarët e Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë:

Agim Bregaj, Agron Përçuku, Alban Bajrami, Ali Januzi, Arlind Gogolli, Behar Duraku, Bekim Zabërgja, Blerina Shala, Bujar Pllana, Edona Gashi, Fakete Dushi, Fatmire Cecelia, Faton Hyseni, Galip Audiu, Gresa Muli, Gentiana Rama, Ilmi Azemi, Kushtrim Hyseni, Leonora Gërguri, Lorik Maxhuni, Mek Selaci, Melihate Basholli-Latifi, Mensur Kasumi, Mensur Kastrati, Mentor Hasani, Nasuf Aliu, Nurie Halili, Nurten Çerkezi-Gjyshinca, Refik Maloku, Shkelzen Xhaferi, Spasoje Stefanoviq, Sylejman Meholli, Ymer Haradinaj dhe Zojë Hajrizi.

Mungoi: Adnan Lahu.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi Melihate Basholli-Latifi, – kryesuese e kuvendit, e cila konstatoi se në sallë janë prezent 34 anëtarë të kuvendit, kuorum ky i mjaftueshëm për zhvillimin e punimeve të mbledhjes plenare dhe për marrje të vendimeve të plotfuqishme, andaj procedoi me rendin e ditës.

Të pranishëm në këtë mbledhje ishin edhe Kryetari i komunës, z. Ferit Idrizi, përfaqësuesi i KFOR-it, përfaqësuesi i OSBE-së, përfaqësues të mediave të shkruara dhe elektronike, përfaqësues të shoqërisë civile.

Melihate Basholli-Latifi, Kryesuese e Kuvendit-paraqiti para kuvendit pika e dërguara në të ndryshme për ti inkorporuar në rendin e ditës.

Faton Hyseni, anëtar i kuvendit –ngriti shqetësimin e normave të tatimit në pronën e paluajtshme, e që lidhet me rritjen e vlerave të tatimit në faturat e cila ka ndodhur pas vlerësimeve që janë bërë nga Ministria e Financave, për tokave dhe objekteve rezidenciale, ka pas këtyre vlerësimeve tatimi në pronë është rritur deri në masën 100% e që i ka goditur drejtpërdrejt qytetarët tanë në këtë kohë të rënd ekonomike, ndërsa për disa këto norma nuk janë rritur pas nuk ka ndryshuar vlera e pronës. Pagesa e tatimit në pronë në Kosovës mund të bëhet në dy këste, afati për këstin e parë është 30 prilli, ndërsa për pagesën e kësti të dytë është fundi i muajit shtator. Lidhur me këtë çështje ai pyeti drejtorin e Drejtorisë së Financave se pas këtyre afateve qytetarët e Komunës së Vushtrrisë a do të gjobiten, apo thënë më mirë a do të aplikohet një kamatë prej 0.65 % për secilin muaj që vonohet pagesa, si dhe një gjobë prej 10% të tatimit të papaguar. Qeveria e Republikës së Kosovës ka marr vendim që të gjithë tatim paguesve tu falen borxhet deri në 100 €,

shtrohet pyetja se a do tu kthen këto mjete qytetarëve që më herët i kanë paguar këto mjete, nëse jo a do të iu zbriten në vitin vijues të njëjtat mjete në shumën e tatimit.

Leonora Gërguri, anëtare e kuvendit- pasi i përshëndeti të pranishmit deklaroi me sa vijon: këtë fjalim timin sot do të dëshiroja shumë që ta filloja me lëvdata për arsimin në komunën tonë ,por ja që realiteti është shumë ndryshe edhe pse Kryetari ka thënë se do e ketë prioritet Arsimin. Anulimi i njëpasnjëshëm i konkurseve, kurdisja e tyre për t'i rehatuar të afërmit e pushtetit dhe për t'i shpërblyer kuvendaret për votat në Kuvend po e degradojnë arsimin në Komunën tonë. Manipulimet që po ndodhin në këto konkurse a janë shkas i dorëheqjeve që po ndodhin po në këtë drejtori duke filluar me dorëheqjen e drejtoreshës se DKA-së dhe tani së fundmi me dorëheqjen e drejtoreshës se çerdhes Foleja.

Ymer Haradinaj, anëtar i kuvendit-ngrit çështjen e një vendimi të kryetarit të komunës, të datës 4 nëntor 2022 ku thuhet se kryetari Idrizi ka bërë vendosjen e flamurit shtetëror të Republikës së Kosovës në rreth rrotullimin në rrugën magjistrale Prishtinë-Mitrovicë, ku vendi i quajtur rrethi i Gojbulës do të quhet rrethi i flamurit. Në këtë rast me këtë vendim kryetari i komunës ka bërë shkelje të statutit të komunës neni 18 pika 1.9 ku thuhet: Kuvendi i komunës nuk mund t'i delegojë përgjegjësitë e veta për marrjen e vendimeve lidhur me: Emërtimin dhe riemërtimin e rrugëve, rrugicave dhe vendeve tjera publike. Lidhur me këtë çështje vlerësoi se kjo kompetencë i takon kuvendit të komunës dhe pyeti se pas këtyre veprimeve a është iniciuar procedura që ky vendim të votohet dhe aprovohet në kuvend.

Sylejman Mehulli, anëtar i kuvendit-vlerësoi se para disa kohe si parti politike kishin reaguar se konkursi për përzgjedhjen e kryetëknikut në laboratorin e QKMF-së është duke u zhvilluar kundërligjshëm, i njëjti pastaj është përmirësuar por prapë ka pasur shkelje, është ndryshuar rregullorja për me i' u përshtatë dikujt që ka aplikuar i afërt me partinë në pushtet dhe për këtë konkurs si përfundim nuk kemi asnjë njoftim se në cilën fazë ndodhet dhe a ka përfunduar si procedurë. Ndërkohë që kanë ndodhur këto shkelje laboratorin ka mbetur pa monitorim sepse nuk ka biokimist dhe shef të diagnostikës nuk ka kryetëknik, në këtë drejtim ka disa përpjeke për zëvendësimin e tyre me ushtrues detyre dhe me rotacion praktika juridike që nuk janë hasur deri më tani. Dy muaj ditë prej se i ka tërhequr vëmendjen për këto probleme po ngjan të ketë pasur të drejt dhe viktima kryesore në këtë gjë është qytetari i Vushtrrisë i cili nuk po merr shërbimet shëndetësore për të cilat komuna është e obliguar të ofroj, kjo për faktin se gjendja në laborator është tepër e rëndë ku nëse i shikojmë parametrat analiza për diagnostifikim të diabetit ka me muaj që nuk bëhet në këtë laborator. Njëanshëm është ndërprerë kontrata me një operator ekonomik me qëllim të lidhjes me një operator tjetër për reganca apo material për analizë të diabetit dhe për këtë pyeti se përse ka ndodhur një gjë e tillë. Pastaj kryetari i komunës duhet të japë përgjigje se çfarë po ndodh me konkurse dhe shkeljet ligjore që po ndodhin në këtë konkurs për zgjedhjen e kryetëknikut në laborator. Tutje shprehu shqetësimin se ka vendime të kuvendit që nuk po respektohen siç është ai i emërtimit të Teatrit të Qytetit “Adem Mikullofci” që në prononcimet publike kemi referencë vetëm Teatri i Qytetit, ndërkohë që nuk është vendosur një pllakë ku ceket emërtimi zyrtar i këtij institucioni me emirin e Adem Mikullofcit. Kërkoj që kjo pllakë të vendoset sa më parë që të jetë e mundur.

Refik Maloku, anëtar i kuvendit-në adresimin e tij para kuvendit pyeti se përse është anuluar konkursi në çerdhen publik “Foleja” dhe në këtë drejtim komisioni kishte nxjerr njoftim, gjë e cila nuk është praktik sepse duhet nxjerr vendim për anulimin e konkursit. Për këtë pyeti se përse është anuluar ky konkurs në çerdhe, pasi si shihet nga konkursi asgjë nuk ka ndryshuar sa përket

aplikantve. Pastaj pyeti se kur do të bëhet emërtimi i shkollave sepse nuk është në rregull të kemi emra SHMU1 dhe SHMU2.

Ferit Idrizi, kryetar i komunës-tha se prej se ka marr mandatin ka qenë i hapur për kooperim dhe ka shfaqur dëshirën për sinergji për bashkim të energjive pozitive për tu shërbyer qytetëve. Lidhur me konkurset ceku se është çështje e zyrtarëve kompetent dhe në njërin nga konkurset ka pasur shkelje pasi që thirrja juridike ka qenë në një akt i cili ka qenë i shfuqizuar. Në këtë kuptim ai pranon se ka pasur anulim të konkurseve por deklaroj se kjo është mirë pasi që kryetari i komunës nuk po pranon të shkelet ligji dhe aty ku sheh se ka pasur shkelje po intervenon në përmirësimin e gabimeve. Në këtë kontekst ai u zotua se aty ky sheh shkelej në konkurse gjithherë do të veprojnë dhe do t'i anuloj ato konkurse. Lidhur me emërtimin e vendit të quajtur rrethi i flamurit njoftoi se nuk është bërë kurrfarë shkelje e statutit pasi nuk është nxjerr vendim për këtë çështje. Vendosija e flamurit është krejtësisht legjitime dhe mendon se është një potezë shumë pozitiv sepse ai vend do të quhet rrethi i flamurit. Lidhur me emërtimin e Teatrit të Qytetit me emrin e aktorit Adem Mikullofci që ka ndodhur më herët, kërkoj nga Drejtoresha e Kulturës që në një afat sa më të shkurtër ta vendos pllakën e emërtimit zyrtar të këtij institucioni. Tutje njoftoi se pas vendosjes së tabelave për shtëpitë-shkolla, shumë shpejt do të veprohet edhe në emërtimin e shkollave me një proces krejtësisht transparentë. Më tej duke ju kthyer sërish konkurseve vlerësoi dhe potencoi se në qeverisjen e tij janë duke u pranuar në punë njerëz meritore pa shikuar përkatësinë partiake dhe jo siç është vepruar në qeverisjen e kaluar.

Leonora Gërguri, anëtare e kuvendit-tha se është për keqardhje vlerësimet e kryetarit të komunës, që akuzon qeverisjen e kalaruar, ndërsa deklaroi se nuk është i gjithëdhijshëm kurse ka përgjigje për secilën temë duke luajtur rolin e juristit dhe role tjera, që në fakt nuk i di.

Sylejman Mehulli, anëtar i kuvendit-deklaroi se reagimet e tyre publike lidhur me shkeljet që kanë ndodhur në konkurset në komunë, po del se kanë qenë të drejta dhe pikërisht për këtë ndihet mirë sepse ka kontribuar në denoncimin e shkeljeve që po ndodhin. Ai e njehe meritën për vendosjen e pllakave në shtëpi-shkolla, por kërkoj që të bëhet edhe vendosja e emërtimit zyrtar për teatrin e qytetit <Adem Mikullofci>.

Isuf Jasahri, drejtor i DBF-së-paraqiti sqarime lidhur me temën e ngritur për tatimin në pronën e paluajtshme që ka të bëjë me ngritjen e normave tatimore, akordimin e komtës dhe gjobave për vonesat në kryerjen e obligimeve tatimore në pronën e paluajtshme.

Albanez Tahirja, drejtor i Drejtorisë së Prokurimit- paraqiti sqarime lidhur me shkëputjen e një kontrate që lidhet me furnizime në fushën e shëndetësisë, ku njoftoj se operatori ekonomik vetë ka kërkuar që të shkëputët kjo kontratë, në pamundësi të furnizimit, sigurimit, garantimit, konform kontratës, sepse i njëjti nuk ka mundur t'i përmbushë obligimet kontraktuale, ndërsa subjekti ekonomik do të dëmtohet duke ju konfiskuar garancioni. Disa seanca më parë i njëjti anëtar i kuvendit ishte shqetësuar për një tjetër kontratë për DDD, por që atë kontratë e kishte vlerësuar “grykë e tenderëve”-OSHP, të njëjtën e ka vulosur dhe komuna si autoritet kontraktues i’u detyrohet zbatimit të vendimeve të OSHP-së.

Ferit Idrizi, kryetar i komunës-arsyetoj para kuvendit propozim-vendimin për mbështetje financiare për Adea Badivukun, ku kërkoj nga të gjitha grupet politike që ta mbështesin propozimin për ofrimin e ndihmës financiare për të njëjtën. Adea është studente-doktorante në piano në SHBA, kjo ka bërë kërkesë Komunës së Vushtrrisë dhe vlerëson se të njëjtës duhet të dalim në ndihmë.

Sylejman Mehulli, anëtar i kuvendit-vlerësoi se një praktikë e tillë e ndarjes së mjeteve përmes kuvendit, nuk është e sinqertë dhe e ndershme, kjo për faktin se kujt po dëshirojmë po i ndihmojmë e kujt nuk dëshirojmë nuk po i ofrojmë ndihmë. Ky vendim në vetvete është i kundërligjshëm

sepse bazuar në rregullore ndarja e këtyre mjeteve bëhet përmes thirrjes publike. Mandej përpos rasteve të mbështetjes së talenteve po kemi edhe rastet humanitare që po kërkojnë ndihmë për shkak të sëmundjeve të rënda dhe fundi i fundit shëndeti është gjëja më e rëndësishme në jetë para çdo gjëje, andaj mjetet duhet të kursehen për këto raste, ndërsa rastet tjera duhet ti shikojnë afatet që të subvencionohen përmes thirrjes publike.

Ferit Idrizi, kryetar i komunës-sqaroi se askënd në asnjë rrethanë nuk e vë në lajthitje, dhe shtoj se thirrja publike për subvencionim bëhet për persona juridik-OJQ, ndërsa për perona fizik mund të merret vendim nga kuvend për ofrimin e ndihmës financiare.

Në fund të debatit jashtë rendit të ditës dhe për rendin e ditës, Kuvendi pas votimit me 31 vota “për” aprovoi këtë:

R E N D I T E

1. Shqyrtimi dhe aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e rregullt e Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë, mbajtur më datë 30 mars 2023;
2. Shqyrtimi i Raportit tremujor për të hyrat dhe shpenzimet buxhetore;
3. Shqyrtimi i Raportit vjetor të punës së ndërmarrjes regjionale të mbeturinave “Uniteti” për vitin 2022;
4. Shqyrtimi i Raportit vjetor të punës së ndërmarrjes regjionale të ujësjellësit “Mitrovica” për vitin 2022;
5. Shqyrtimi i Raportit të vlerësimit të dëmeve nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera në territorin e komunës së Vushtrrisë të shkaktuara në muajin mars 2023;
6. Shqyrtimi i Propozim-vendimit për ofrimin e mbështetjes financiare për Adea Badivukun;
7. Shqyrtimi i Propozim-vendimin për ndryshim të vendimi 01 Nr. 24/22 date.31.01.2022 për themelimin të Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi;
8. Të ndryshme.

1. Shqyrtimi dhe aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e rregullt e Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë, mbajtur më datë 30 mars 2023;

Pas shqyrtimit të kësaj pike të rendit të ditës, Kuvendi me vota “unanime”, aprovoi procesverbalin nga mbledhja rregullt e Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë, mbajtur më datë 30 mars 2023.

2. Shqyrtimi i Raportit tremujor për të hyrat dhe shpenzimet buxhetore;

Leonora Gërguri, anëtare e kuvendit-tha ky raport në aspektin profesional lë shumë për të dëshiruar, duke filluar nga tabela e të hyrave ku tek komenti kemi ngatërrim të shumave i cili nuk ka të bëjë me realitetin e që vetë e keni shënuar në tabela. Po ashtu kemi rënie në inkasimin e të hyrave në krahasim me vitin e kaluar përreth 33,000.00 €, ndërsa këtij raporti i mungon lista e projekteve kapitale të planifikuara apo ndoshta kjo është bërë me qëllim të shihet realiteti, sepse kur e shohim tabelën e shpenzimeve sipas kategorive të larta shihet se realizimi për investime kapitale për këtë periudhë është 0%. Ndërsa për kategorinë mallra dhe shërbime shihet se për disa kode ekonomike kemi shpenzime të dy-trefishuara, por dy më të veçanta dhe më luksoze janë ato

të udhëtimit jashtë vendit 3600 € dhe avansi për udhëtime jashtë-vendit rreth 27,000.00 € e që kjo është bërë për përfitimin e mëditjeve për zyrtarët komunal.

Sylejman Mehulli, anëtar i kuvendit-tha se ka shpresuar se drejtori i ri i financave, z.Jashari, do të punoj në ngjalljen dhe shtyrjen përpara të proceseve në financat publike të komunës së Vushtrrisë të cilat kanë qenë të katandisura si mos më keq gjatë vitit 2022 ku kemi pasur rekorde fatale të suficitit të parasë publike në Komunën e Vushtrrisë. Duke ju referuar tabelave vlerësoi se përpos që po mungon transparenca në shpenzimin e parasë sidomos në projekte kapitale që është pjesa kryesore. Tutje duke ju referuar faqes 2 të raportit tha se kemi një fjali e cila është bërë me qëllim për të keq informuar apo kamufluar situatën, ku thuhet: planifikimi i të hyrave vetnanake është për periudhën janar-mars 2023 është 2,262.795 € ndërsa realizmi është 725,139.75 €, e që shprehur në përqindje i bie që është 90.55% e kjo është gabim shumë keq informim, sepse nëse kalkuloheh shuma e sipër cekura në mënyrë të drejt del se përqindja sipas formulës del se është vetëm 32% e jo ajo që na është prezantuar, por kjo ka vetëm një shpjegim tendencë për kamuflim të dështimeve.

Isuf Jasahri, drejtor i DBF-së-paraqiti sqarime lidhur raportin për të hyrat dhe shpenzimet buxhetore, duke u përgjigjur në temat e ngritura nga anëtarët e kuvendit. Tutje ai shtoj se kemi pasur një periudhë progresiste, edhe për kundër rrethanave rëndues që kanë mbretëruar si rezultat i aprovimit të buxhetit të komunës por edhe rrethanave tjera ekonomike jo favorizuese në përgjithësi. Në vazhdim ai para kuvendit parashtrij statistika financiare lidhur me të hyrat dhe shpenzimet buxhetore për periudhën raportuese të cekur si më lartë.

Sylejman Mehulli, anëtar i kuvendit-përsëriti qëndrimin e tij se ka gabime në kalkulimin e përqindjeve për sa i takon shpenzimit të buxhetit në investime kapitale, dhe vlerësoi se shpenzimi për investime është tmerrësisht i ulët duke shkuar fondet gati në tërësi në suficit.

Në fund të debatit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës kuvendit pas votimit me 20 vota “për” 8 vota “kundër” aprovoj Raportin tremujor për të hyrat dhe shpenzimet buxhetore.

3. Shqyrtimi i Raportit vjetor të punës së ndërmarrjes regjionale të mbeturinave “Uniteti” për vitin 2022;

Bekim Zabergja –anëtar i kuvendit- theksoi se para se të diskutoj për këtë pikë të rendit të ditës, kam një pyetje Kryetari dhe Sylejman Mehulli i ndanë rolet, kryetari mbeti të thërras Kryeministrin dhe Ministrin e Kulturës, shtroi pyetjen se kush mbeti të thërras Martin Berishajn dhe Nagip Krasniqin. Me tutje filloi diskutimin për pikën e rendit të ditës , me Ligjin e Ndërmarrjes Publike 03/L-037 të gjitha ndërmarrjet publike qofshin ato qendrore apo lokale veprimtarinë e tyre sipas këtij ligjin si dhe rregulloret që kërkohen sipas Ligjit për Shoqëritë Tregtare. Ndërmarrjet publike që janë në pronësi të Komunës apo komunave ,në këtë rast ndërmarrja është në pronësi të tri komunave. Kur je komunë është aksionar ne një ndërmarrje lokale komuna cakton një komision komunal i cili ka te drejt te veproj ne emër te komunës dhe duhet të veproji ne përputhje te plote me Ligjin për Shoqëri Tregtare dhe me shumicë të thjesht vendos t’i ushtroj te drejtat e aksionarit te komunës. Komisioni komunal i aksionare ne baze te nenit 16,paragrafi 16.1 dhe 16.2 zgjedh borin e drejtorëve i cili përbehet nga 5 drejtor, 4 drejtor zgjedhën nga komisioni i aksionarëve , ndërsa drejtori i 5 i cili është krye shef ekzekutivë i cili zgjidhet nga bori i drejtoreshave në përputhje me nenin 21 te këtij ligji. Me tutje tha, komisioni i aksionarëve zgjedh borin e drejtorëve, ndërsa bori i drejtorëve emëron zyrtarët e ndërmarrjes publike siç është kryeshefi ekzekutiv ,zyrtarin

kryesor të financave dhe thesarit ,këshilltarin e përgjithshëm(sekretarin për auditim të brendshëm). Më tutje tha, se krye shefi ekzekutiv i raporton bordit të drejtorëve, bordi i drejtorëve i raportin komisionit komunal të aksionarëve ,ndërsa komisioni komunal i aksionarëve i raporton kuvendit. Pra në baze të kësaj kuvendit komunal ka të drejt t'i raportoj komisioni komunal i aksionareve e jo krye shefi ekzekutiv siç është ne këtë rast. Shtroi pyetjen, ku është komisioni komunal i aksionareve a është prezent ne salle , ne baze te planit te punës se kuvendit keni pasur te raportoni ne muajin Prill me sjell raportin. Pse nuk e keni sjell raportin sipas përgjegjësive te juaja, vetëm raportin tuaj ky kuvend ka të drejt ta votoj. Ky është vetëm një eksport i raporti të kryeshefit ekzekutiv. Kërkoj që kjo pikë e rendit të ditës të shtyhet për mbledhjen e ardhme dhe në mbledhjen e ardhme komisioni kuvendar i aksionarëve të sjell raportin sipas Ligjit për Ndërmarrje Publike. Raporti i krye shefit ekzekutiv nuk prodhon asnjë efekt juridik për kuvendin.

Melihate Basholli-Latifi-kryesuese e kuvendit- tha, propozimi i Bekim Zabergjes ishte që ky raport të shtyhet dhe të vjen raporti nga komisioni i aksionarëve dhe jo nga kryeshefi ekzekutiv.

Refik Maloku-anëtar i kuvendit- tha, se ai vete është pjesë e këtij komisioni së bashku me Galip Avdiun anëtar i kuvendit dhe Benajmin Shalën drejtor i shërbimeve publike. Me tutje tha se pajtohet me çdo pike dhe presjen me Bekim Zabergjen, është e vërtet që nuk kemi pasur takim prej kohës se formimit si komision me krye shefin ose me ndërmarrjen “Uniteti”. Me tutje tha kanë pasur vetëm dy takime si komision i aksionarëve me drejtorin dhe anëtarin tjetër dhe janë kanë ra dakord që kjo pike e rendit të ditës mos të sillet fare në këtë seancë, të takohet komisioni i aksionarëve me kryeshefin dhe të përpilohet një raport te mirëfilltë pasi që ky raport edhe ashtu ka shume te meta dhe paqartësi. Shprehi qe janë te pakënaqur me raportin dhe veprimet e “Unitetit” ne Komunën e Vushtrisë. Për muajin e ardhshëm te përgatitet një raport i detajuar dhe te sjellët nga komisioni i aksionarëve.

Meqë ishin dy propozime për shtyrjen e kësaj pike, kryesuesja e kuvendit e hodhi në votim propozimin për shtyrjen e kësaj pike të rendit të ditës.

Pas debatit lidhur me këtë pike të rendit te ditës, Kuvendi pas votimit me vota “unanime “ vendosi që kjo pikë e rendit të ditës të shtyhet për mbledhjen e ardhshme.

4. Shqyrtimi i Raportit vjetor të punës së Ndërmarrjes Regjionale të Ujësjellësit “Mitrovica” për vitin 2022;

Melihate Basholli-Latifi-kryesuese e kuvendit- njoftoi se të pranishëm ne seance janë Shefqet Maloku menaxher i njësisë operative ne Vushtrri dhe Bujar Asllani zyrtar financiar ne KRU “Mitrovica”.

Faton Hyseni- anëtar i kuvendit-tha, se për Sheqfet Maloku dhe për punën që është duke e kryer ujësjellësi nga koha kur jemi kyçur në ujësjellës nuk kemi pasur ndërprerje. Ndërprerjet kanë ndodhur vetëm dy herë, një herë për shkak të vërshimeve dhe një herë për shkak të rregullimeve në rrugë deri sa është bërë rregullimi i gypave dhe jemi informuar. Tha se e morri fjalën vetëm për të uruar dhe përgëzuar.

Bekim Zabergja –anëtar i kuvendit-tha, se kemi të bëjmë me ndërmarrje regjionale ku aksionar kryesor është Qeveria e Republikës së Kosovës, komisioni aksionar i raporton qeveris jo kuvendit të komunës mirëpo në aspektin moral një informatë të jepet nga krye shefi ekzekutiv për shkak se

e ka një komunë monopolin për ta furnizuar me ujë dhe shërbime të tjera Komunën e Vushtrrisë. Më tutje kërkoi që kjo pike e rendit të ditës të shtyhet që të vije kryeshefi ekzekutiv të jep informatë sepse nuk mundet i njësisë për shkak të përgjegjësive. Le të vije kryeshefi dhe të raporton vetë. Iu drejtua menaxherit të njësisë operative të Vushtrrisë të përgjigjet për të gjitha shifrat që janë në raport. Kërkoi nga anëtarët e kuvendit t'i jepet fjala drejtorit të financave pas që ka qenë zyrtar kryesor financiar në KRU "Mitrovica" dhe e njeh mire këtë fushe mirë.

Isuf Jashri-drejtor i financave- tha, se KRU "Mitrovica" është në gjendje të rend ekonomike financiare për shkak se i posedon dy fabrika të ujit. Janë fabrika e Balincit që e furnizon Vushtrrinë dhe fabrika e Shipolit që e furnizon Mitrovicën e Jugut ,Mitrovicën e Veriut dhe Skenderajn. Në bazë të statistikave që janë prezantuar janë disa në raport mos barazimi, një problem është që Mitrovica e Veriut i ka mbi 17 milion borxhe kompanisë së ujësjellësit dhe nuk ceket në raport, nëse thuhet e kemi një performac pozitive atëherë niveli qendror asnjë subvencion nuk do të i jep kompanisë se nga kjo kuptohet që kompania mund të mbijetoj ndërsa ka asete dihet se në çfarë gjendje është njësia e Vushtrrisë ka një kamionë dhe një traktor me një lug që nuk mund të hapet një kanal askund. Inkasimi në Mitrovicë është 1,966.108 € ndërsa shpenzimet 2,657.766, inkasimi në Vushtrri është 1,240.499 ndërsa shpenzimet 1,3900.786, në Skenderaj inkasimi 531,224,00 shpenzimet 553,258.00. Në baze të kësaj Vushtrria përpos realizimi që e ka bërë i ka mbuluar shpenzimet e veta dhe i ka ndihmuar regjionit me 270000.0.13, dihet që regjioni ka shpenzime të mëdha ,në baze të kësaj performace të thuhet që është një performac pozitive ndërsa obligime janë enorme të mëdha 53%,atëherë nuk do te keni asnjë subvencion. Sa i përket prezantimit këto janë të dhëna reale të gjendjes faktike.

Agim Bregaj, anëtar i kuvendit- tha, në këtë raport në disa vende thuhet se Vushtrria i ka punët mirë sepse ka inkasim dhe faturim 40% ndërsa humbje 60% si mund të jetë pozitive. Ndërsa Skenderaj inkasim dhe faturim 25%,humbje 65%,ndërsa Mitrovica 30% të hyra dhe të dalura ndërsa të dalura 70%. Në fund thuhej se kompania është e suksesshme 107% ka dalur me suksese. Me tutje shtori pyetjen a mundet me na e shpjeguar dikush këtë. Nëse Skenderaj është më keq se ne, duhet t'i ndihmojmë sepse jemi shumë bamirës.

Ymer Haradinaj, anëtar i kuvendit- tha, se e ka analizuar këtë raport ku diku thuhet raport diku informatë duhet të dihet a është raport apo informatë. Në tabelën thuhet se kemi paraqitur të dhëna për anëtar të bordit të përkohshëm për periudhën 01.01.2022 deri 14.01.2022 pra raporti është vetëm për 13 dite e jo për një vit. Në tabelën 3 tek bordi i drejtorëve jo-ekzekutivë thuhet që po raportoj për periudhën 01.06.2022 deri me 31.01.2022 kemi dyshime që vetëm janë marr copy-past ,është papërgjegjësi totale thuhet që po raportojë kështu mbrapsht. Më tutje tha, se është një raportim joserioz sepse duhet të dihet që po i raportohet kuvendit të komunës pra asamblesë komunale që është zgjedhur nga qytetaret. Shqetësuese është që në regjionin e Mitrovicës vetëm 12% e konsumatorëve kanë marrëveshje shërbimi me ndërmarrjen, në Vushtrri 10% ndërsa në Skenderaj 6% nga kjo del që pagesa (inkasimi) është shumë mirë në krahasim që qytetarët nuk kanë marrëveshje pra nuk kanë obligim për pagimin e këtyre taksave. Në tabelën 25 tek numri i punëtorëve thuhet që 239 meshkuj dhe 2 femra në total 264, 239 dhe 2 bëjnë 241 e jo 264. Po ashtu në tabelën 4 lëvizja e punonjësve gjatë vitit 2022 thuhet që numri i të punësuarve që i'u është ndërpret kontrata gjate vitit 2022 është 4 persona nuk ka ndonjë raport se cila është arsyeja e ndërprerjes së kontratës. Më tutje tha që po flitet për një raport të Ndërmarrjes së Ujësijellësit kërkoi që kryeshefi të ishte prezent sepse duhet një koordinim shumë më i mire i kryeshefit ekzekutiv dhe i kësaj ndërmarrjen me Komunën e Vushtrrisë sepse edhe sot kur po flitet ka fshatra të tëra të Komunës se Vushtrrisë që kanë mungesë të ujit të pijes. Në raport janë paraqitur të dhëna të sakta

ndërsa njerëzit në këto fshatra në zonat e larta si Stanoci i Epërm ,tri Dumnicat, Samadrexhë dhe Ceceli mos të përmenden të gjitha fshatrat pra qytetarët kanë mungesë elementare të ujit ndërsa në raport thuhet që gjerat janë mirë. Kërkoi që të këtë bashkëpunim më të ngushtë të ndërmarrjes publike siç është në këtë rast Ujësjellësi “Mitrovica” me kryetarin e komunës dhe qeverinë komunale dhe sa më shpejt qytetarëve të Vushtrrisë të i’u bëhet zgjidhja për ujin e pijes këtu po flitet por qytetarët të cilët nuk e kanë gjënë elementare që është uji i pijes.

Refik Maloku-anëtar i kuvendit-tha se ka pasur fatin apo fatkeqësinë të merret me këtë problematik ,problemi i parë qendror në ligj. Kryetari dhe qeveria është e obliguar të furnizoi qytetarët me ujë, as kryetari as qeveria nuk kane asnjë kompetencë mbi kompaninë e cila e bënë furnizimin me ujë krejt çka mund te behet një bashkëpunim me mirëbesim dhe mirëkuptim. Pra asnjë kompetencë nuk e ka kryetari as qeveria komunale nuk e ka mbi kompaninë e ujësjellësit tjetër kush e zgjedh bordin dhe kryeshefin ,qytetari vjen dhe kërkon ujin nga Kryetrari dhe qeveria komunale. Këto janë disa probleme që duhet të rregullohen me ligj sepse komuna përveç që e ka obligim të siguroj ujë për qytetarët të këtë edhe një lloj autoriteti mbi kompaninë e cila e bënë furnizimin me ujë. Problemi kyç është ky për të tjerat ne mund të flasim me thirr kryeshefin, kjo është vetëm mirëkuptim i kryetarit me kompaninë përndryshe kryetari nuk ka asnjë kompetencë mbi kompaninë.

Sylejman Mehulli, anëtar i kuvendit- kishte pyetje për zyrtarët e ndërmarrjes se ujësjellësit, në vitin e kaluar një qytetar i Komunës së Vushtrrisë është dërguar nga kompania juaj tek përmbaruesi privat për një borxh për një periudhë të raportimit i cili ka pasur dëshmi të raportimit të cilën ka pasur dëshmi nga ana e juaj që është shkyçur nga ujësjellësi sepse ata kanë ndërruar vendbanimin nga një fshat në Vushtri. Me fletë dëshmi e cila i është lëshuar nga punëtori i ndërmarrjes që është çkyqyr në vitin 2016 është cekur që shkyçet përgjithmonë nga ajo adresë dhe faturimi kalon në një adresë tjetër në X lagjen në Vushtri. Në vitin 2020 e dërgon tek përmbaruesi vete kompania për të njëjtën periudhë ku vetë kompania ka dëshmuar me fletë raportim mund të sigurohet me fakte e dërgon qytetarin tek përmbaruesi me borxh paushall për periudhën që vetë kompania e ka çkyqyr me dokument ,për këtë periudhë qytetari ka edhe dëshmitar e ka edhe fletë raportin e juaj që nuk banon aty dhe nuk ka shpenzuar aty. Me tutje theksoi se vetë ka qenë në ndihem juridike të qytetarit ka bërë ankesë tek ju ka bashkangjitur edhe raportin që kompania ia ka bërë që është çkyqyr dhe prapë i është refuzuar ankesa është dashur të dërgohet në gjykatë që t’i bëhet prapsim juridik dhe prapë nuk i’u është larguar komplet barra. Ka me qindra raste që janë duke pësuar nga këto denoncime që është duke bërë kompania tek përmbaruesi nga kjo janë duke u dëshpëruar qytetarët të paguajnë fatura për këtë arsyeje keni dështim në inkasim, më tutje shprehi se ju lutet zyrtarëve juridik të kompanisë që të jenë në nivel të detyrës.

Ali Januzi, anëtar i kuvendit- tha, edhe në legjislaturën e kaluar ka qene një debat meqë Vushtrria e ka fabrikën në Vushtri nuk varemi nga fabrika në Shipol ,Vushtrria me 66 fshatra e ka fabrikën në Balinc. Më tutje tha, se e ka një propozim dhe është mire që kjo iniciative të filloi ,procedurat gjyqësore nuk i di si shkojnë por propozimi ime është që të merret një iniciativë që të mos varemi nga regjioni por të shkëputemi nga regjioni. Para një kohe jemi varur nga fabrika në Shipol por tani nuk varemi ,kemi fabrikën tonë të ndërtuar me standarde shumë të mira. Kishte me qenë mirë të merret kjo iniciative që Komuna e Vushtrrisë të shkëputet nga regjioni pse të varemi nga regjioni, të kemi drejtorin tonë, teknikët tonë dhe stafin tonë ,këtë ujësjellës ta menagjon Komuna në bashkëpunim me ujësjellësin tonë.

Shefqet Maloku, menaxher i njësisë operative në Vushtrri KRU “Mitrovica”- foli para anëtarëve të kuvendit, informoi se janë të deleguar nga kryeshefi ekzekutiv KRU “Mitrovica” ,pasi që kryeshefi është në mbledhjen e bordi në pamundësinë për të ardhur në kuvend. Kryeshefi ka deleguar dy zyrtar , një zyrtar nga njësia operative Vushtrri dhe një zyrtar nga qendra në Mitrovicë. Me tutje dha sugjerimin që të gjitha pyetjet që keni në drejtim të njësisë operative Vushtrri ,jo për qendrën pasi që qendra raporton diku tjetër. Me tutje tha, për të gjitha pyetjet do të mbajnë shënime dhe do t’i adresojmë në qendër, do të mundohemi t’i zgjidhim bashkërisht. Në njësinë operative të Vushtrrisë furnizimi me ujë nga koha kur ka kaluar 24/7 është furnizim i mire. Përveç kur ka ndonjë ndërhyrje në rrjet edhe në atë rast informohen qytetarët nga mjetet e informimit nga KRU “Mitrovica”. Për të gjitha pyetjet që i parashtroni njësisë operative në Vushtrri do t’i mbajmë dhe do t’i adresojmë ne Mitrovicë.

Bekim Zabergja, anëtar i kuvendit- adresoi pyetje në drejtim të përfaqësuesve të KRU “Mitrovica”, për vitin 2022 prodhimi në metër kub ka qenë 7,240,885 litra janë faturuar, uji i pa faturuar 4361,877 litra nga kjo sasi janë faturuar vetëm 2,879,008 metër kub apo 40% e sasisë se prodhuar është faturuar që i bije 60% e ujit të prodhuar e pa faturuar llogaritet humbje teknike rrjedhje nëntokësore rrjet i stervjetruar që nuk garanton cilësi pra fabrika çdo vit prodhon dhe faturon më pak ujë sesa që e blenë ndërsa në fabrikë është ora matëse Ndërmarrja Publike “Iber-Lepenci”. Çka ka ndërmarr kompania në kuadër të investimeve kapitale për ndërrimin e këtyre gypave, për ndërrimin e mjeteve themelore të cilat janë vjetërsuar. Sepse çdo vite figuron që po prodhon shumë më shumë e po faturon shume më pak.

Melihate Basholli-Latifi, kryesuese e kuvendit-falënderoi menaxherin për informacionet që i ka dhënë përmes kësaj informate u njoftuan anëtarët e kuvendit dhe qytetarët për performancën e KRU “Mitrovica”. Kërkoj nga Kryetari i Komunës të vazhdoj dhe të ngrisë bashkëpunimin me ndërmarrjen. Njëkohësisht të përkrahjet propozomini i Ali Januzit që Vushtrria të jetë e pavarur dhe të shfrytëzohet uji për qytetarët e Vushtrrisë.

5. Shqyrtimi i Raportit të vlerësimit të dëmeve nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera në territorin e Komunës së Vushtrrisë të shkaktuara në muajin mars 2023;

Leonora Gerguri anëtare e kuvendit- tha se një raport i ngjashëm na ka ardhur në seancën e muajit të kaluar që ka përfshirë periudhën nëntor-dhjetor 2022 dhe janar-shkurt-mars 2023 njëjti ka ardhur për periudhën mars 2023 me arsyetimin që nuk kanë mundur t’i përmbushën afateve kohore po i njëjti ky që ka ardhur thotë që do t’i bashkëngjisim edhe një pasqyrë tabelare të kërkesave dhe vlerësimit të dëmeve nga ana e komisionit dhe kjo tabelë i mungon këtij raporti është konfuze se çfarë jemi duke votuar në këtë raport kur është i mangët.

Melihate Basholli-Latifi, kryesuese e kuvendit- tha, për këtë çështje duhet të merret një vendim për shkak se i njëjti nëse do të ketë implikime buxhetore pas vlerësimit të komisioni dërgohet në AME dhe duhet të merret një vendim për kompensim sipas informacioneve të drejtorisë.

Maliq Ferizi, drejtor i Drejtorisë së emergjencave- tha, mundemi edhe të shtyhet, këtu vetëm komisioni ka bërë një gabim për shakë të vrullit të madh të punës që ka pasur me subvencione nuk kanë mundur të shtinë këtë fermer këtë muaj e kanë sjell që të futet ky fermer.

Nasuf Aliu, anëtar i kuvendit- tha, a kemi të bëjmë me vlerësimin e situatës në krejt qytetin apo vetëm me një rast sepse këtu është vetëm një familje.

Melihate Basholli-Latifi, kryesuese e kuvendit- tha, është një rast në fshatin Pestovë vërshim nga shiu dhe një rast tjetër në fshatin Novoloan nga zjarri. Shuma totale është 5204.80 euro.

Ferit Idrizi, kryetar i komunës- tha, se pari është një punë jashtëzakonisht e mirë sepse janë menaxhuar vërshimet dhe nuk ka dëme shifra të mëdha por nuk është e mirë për shkak se raporti është dashur të jete shumë i specifikuar dhe të dihet se çka po kërkohet d.m.th. është dashur. Ky vendim që merret shkon në qeveri dhe qeveria i ndan këto mjete, nuk ndahen nga Komuna e Vushtrrisë pra kjo është një lloj kërkese që me vendim të kuvendit këto dëme të shkaktuara gjatë periudhës së vërshimeve sa ka qenë. Falë punës shumë të mirë që ka bërë drejtorja e emergjencave dhe është duke punuar edhe këto ditë në pastirmimin e lumenjve, përrenjve dhe perrockave kësaj radhe kemi shpëtuar, kjo nuk na jep komoditet duhet të vazhdojmë pastrimin e lumenjve në tërë territorin e Komunës së Vushtrrisë.

Melihate Basholli-Latifi, kryesuese e kuvendit- tha, ne nuk mund të marrim vendim, mund vetëm ta aprovojmë raportin pastaj kryetari në baze të këtij raporti mund të bëjë kërkesë në ministri.

Pas debatit lidhur me këtë pike të rendit të ditës ,Kuvendi pas votimit me 15 vota “për”, 14 vota “kundër” aprovoj raportin e vlerësimit të dëmeve nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera në territorin e Komunës së Vushtrrisë të shkaktuara në muajin mars 2023.

6. Shqyrtimi i Propozim-vendimit për ofrimin e mbështetjes financiare për Adea Badivukun;

Sylejman Mehulli, anëtar i kuvendit- tha se pas sqarimeve ligjore që u bënë nga zyra ligjore, do ta mbështesin këtë propozim-vendim, por kërkojnë që të mbështetet financiarisht edhe znj. Kaltrina Maloku, e cila është e vetmja doktorante e shkencave aplikative-profilin aplikimi i matematikë në klimëatologji, e cila së fundmi ka prezantuar disa projekte.

Pas shqyrtimit të kësaj pike të rendit të ditës Kuvendi pas votimit me vota “unanime” vendosi me sa vijon:

1. Me këtë vendim znj. Adea Badivuku, studente e doktoraturës në piano, i ofrohet përkrahje financiare në shumë prej tremijë euro (3,000.00 €) për realizim të projektit me karakter ndërkombëtar, për promovim dhe avancim të kulturës dhe artit në Kosovë që do të realizohet nga data 22-28 qershor 2023 në Prishtinë.

2. Mjetet financiare të cekur në pikën paraprake të këtij vendim do të sigurohen nga buxheti i komunës – kategoria subvencione dhe transfere, të Drejtorisë për Kulturë Rini dhe Sport.

3. Përfituesi mjeteve financiare nga pika 1 e këtij vendimi duhet të dorëzojë në komunë – Drejtorinë për Buxhet dhe Financa brenda 7 ditësh pas përfundimit të projektit raport kthyes për shfrytëzimin e subvencionit,

4. Për zbatimin e këtij vendimi obligohen: Drejtorja për Buxhet dhe Financa dhe Drejtorja për Kulturë Rini dhe Sport.

5. Ky vendim hyn në fuqi shtatë (7) ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

7. Shqyrtimi i Propozim-vendimin për ndryshim të vendimi 01 Nr. 24/22 date.31.01.2022 për themelim të Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi;

Pas shqyrtimit të kësaj pike të rendit të ditës Kuvendi pas votimit me vota “unanime” vendosi me sa vijon:

1.Me këtë vendim ndryshohet vendimi 01 Nr. 24/22 date.31.01.2022 për themelim të Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi si në vijim:

1.1 Në paragrafin 1, pika 1.3 z.Dardan Abazi, Drejtor i DKA-së, caktohet anëtar i KKSB-së.

2. Për zbatimin e këtij vendimi obligohet Zyra e kryetarit dhe Sekretaria e Kuvendit.

3. Ky vendim hyn në fuqi shtatë (7) ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

Mbledhja përfundoi në ora: 12:15.

Bastri Duraku

Melihate Basholli-Latifi

Procesmbajtës

Kryesuese e Kuvendit



Republika e Kosovës

Komuna Vushtri

Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport

DATE	05 maj 2023
REFERENC	03/ /2023
PER	KPF-në dhe KK-në
PËRMES	Sekretarisë së Kuvendit
NGA	Znj. Medina Bunjaku, Kryesuese e Komisionit 
TEMA	Propozimet e Komisionit për ndarjen e dekoratave në rastin e shënimit të Ditës së Çlirimit, më 17 Qershor 2023

- 20. Driton Morina nga Akrashtica- për prodhimtari të lartë në bujqësi.**
- 21. Sabedin Hajredinaj nga Stanoci i Epërm- fermer i dalluar në blegtori.**
- 22. Sedat Kasumi nga Pestova – për arritjen e rendimenteve të larta në kultivimin e patates.**
- 23. Vjendita Pllana- në SHMU “Bahri Kuqi”, për sukseset e arritura në garat kombëtare të organizuara nga Instituti i Gjuhës “Gjuhëtari i Ri”.**
- 24. Merita Ademi – arsimtare e dalluar e matematikës në SHMU “Bahri Kuqi” Shtruhërë.**
- 25. Vjollca Pllana – arsimtare e dalluar e gjuhës dhe letërsisë shqipe në SHMU “Bahri Kuqi” Shtruhërë.**
- 26. Muhamet Xhemajli (post mortum)- ish-drejtor në SHMU “28 Nëntori” në Vërnice, për kontributin e dhënë në themelimin e kësaj shkolle.**
- 27. Afërdita Dervishi – inxh. e diplomuar, e persekutuar, e përndjekur dhe e dënuar padrejtësisht nga regjimi i asaj kohe.**
- 28. Ferki Kadriu nga Novolani – bujk i suksesshëm.**
- 29. KV nga Shtruhëra – për sukseset e arritura në volejboll.**
- 30. SHM Gjimnazi “Eqrem Qabej” – për rezultatet e arritura në nivel të Republikës së Kosovës.**
- 31. Mexhit Merovci – mërgimtar, për kontributin e dhënë për ndërtimin e shtëpive për familjet e pastrehë.**

- 32. Kryqi i Kuq (Vushtrri)– për kontributin e dhënë në shërbim të qytetarëve të Komunës së Vushtrrisë.**
- 33. Mexhit Përçuku – për rezultate në punë në lëmin e financave.**
- 34. Mursel Bllata – (post mortum) për akt trimërie në mbrojtjen e nderit të familjes.**
- 35. Arbnor Gashi – (nxënës) për rezultatet e arritura në lëmin e matematikës.**

MIRËNJOHJE – VITI 2013

1. Behar Mehdi Haziri, bir i Dëshmorit, student i dalluar;
2. Besarta Enver Musa, bijë e Dëshmorit nxënëse e dalluar;
3. Kaltrina Avni Saraçi, bijë e Dëshmorit nxënëse e dalluar;
4. Sadik Halili, i plagosur në Prekaz tek familja Jashari, në luftën kundër forcave pushtuese serbe, për sakrificë në çlirimin e vendit;
5. Sheshivar Shala, invalid i luftës së UÇK-së - për kontribut të dhënë gjatë luftës në Kosovë;
6. Brahim Gërxhaliu anëtar i familjes martire – për martirizim të anëtarit të familjes gjatë luftës në Kosovë;
7. Vildane Mulaku kryefamiljare e familjes martire – për martirizim të anëtarit të familjes gjatë luftës në Kosovë;
8. Hatixhe Gërxhaliu anëtar e familjes martirë – për martirizim të anëtarëve të familjes gjatë luftës në Kosovë;
9. Muhamet Aliu, veteran i luftës së UÇK-së, për kontributin e dhënë gjatë luftës në Zonën Operative të Shalës;
10. Sheremet Saraçi, veteran i luftës së UÇK-së, për kontributin e dhënë gjatë luftës në Zonën Operative të Shalës;
11. Osman Musliu, veteran i luftës së UÇK-së, për kontributin e dhënë gjatë luftës në Zonën Operative të Shalës;
12. Salih Salihu, veteran i luftës së UÇK-së, për kontributin e dhënë gjatë luftës në Zonën Operative të Shalës;
13. Behxhet Jashari, veteran i luftës së UÇK-së, për kontributin e dhënë gjatë luftës në Zonën Operative të Shalës;
13. Rexhep Mehmeti, i burgosur politik, për kontributin e dhënë për çështjen kombëtare;
14. Ilmi Muzaqi, i burgosur politik, për kontributin e dhënë për çështjen kombëtare;
15. Naser Tahiri, i burgosur politik, për kontributin e dhënë për çështjen kombëtare;
16. Filip Gjonci, drejtor i Arsimit Durrës - për bashkëpunim të suksesshëm me Drejtorinë e Arsimit në Komunën e Vushtrrisë, në ngritjen dhe forcimin e procesit mësimor-edukativ;
17. Kastriot Kodheli, drejtor i Arsimit Lezhë - për bashkëpunim të suksesshëm me Drejtorinë e Arsimit në Komunën e Vushtrrisë, në harmonizimin e punës së planeve zhvillimore në shkolla;
18. Devim Yoruk, drejtor i Kolegjit “Mehmet Akif” Banullë – Lipjan për bashkëpunim të suksesshëm dhe ndihmë në fushën e vlerësimit të nxënësve;
19. USAID/DEMI - Iniciativa për komuna efektive demokratike, - për mbështetje të komunës në projekte të shumta si dhe përkrahje në ngritjen e performancës komunale;
20. Sahit Parduzi, Drejtor i SHMU - II, - për rezultate në punë në SHMU – II në Vushtrri;
21. Isak Bajrami (post mortum), ish drejtor i SHMU “A.Z. Çajupi” – Vushtrri, për menaxhim të suksesshëm edukativo-arsimor dhe sportiv në Komunën e Vushtrrisë;
22. Dr. Isak Berisha, kirurg, Spitali “Sheik Zayed”- Vushtrri, për kontributin e dhënë në fushën e shëndetësisë;
23. Bekim Selmani, për rezultate në punë në administratën e komunës;

- 24. Agim Munishi, koreograf i Ansambllit të këngëve dhe valleve “Hasan Prishtina” në Vushtrri, për rezultate të shumta në koncerte dhe festivale në nivel vendi dhe ndërkombëtar;**
- 25. Vedat Hyseni, Ashlan - bujk i dalluar në Komunën e Vushtrrisë;**
- 26. Baki Haradinaj, Stanoc i Epërm - fermer i dalluar në blegtori në Komunën e Vushtrrisë;**
- 27. Muhamet Sfarqa, Studime e Poshtme - bletar i dalluar në Komunën e Vushtrrisë;**
- 28. Kompania “Ariani” Vushtrri, për biznes të suksesshëm dhe punësim në veprimtarinë biznesore;**
- 29. NPT “Preteni”, biznesmen i suksesshëm në prodhimin e dyerve dhe dritareve;**
- 30. Kompania “Albed” Vushtrri, për biznes të suksesshëm;**
- 31. Halim Ferati (post mortum), ish i burgosur politik;**
- 32. Tafil Mërnica (post mortum), veprimtar i çështjes kombëtare;**
- 33. Komuna Mamak (Turqi), për bashkëpunim të suksesshëm dhe avancim të qeverisjes lokale;**
- 34. Komuna Saruhanli (Turqi), për bashkëpunim të suksesshëm dhe avancim të qeverisjes lokale;**
- 35. Rrahim Tahiri, veteran i UÇK-së, për kontributin e dhënë në luftën e UÇK-së;**
- 36. Faruk Sunguri, për kontributin e dhënë në zhvillimin e jetës kulturore;**
- 37. Feriz Zekolli, për kontributin e dhënë në pajtimin e gjaqeve;**
- 38. Milot Rashica, futbollist i dalluar;**
- 39. Bashkia e Fierit, për bashkëpunim të suksesshëm dhe avancim të qeverisjes lokale;**
- 40. Florent Hasani, sportist i dalluar.**

LISTA PËR DEKORATA 2014

Me cmimin Nderi i Qytetit nderohen:

- . Safet H. Ajeti – Dëshmor i Kombit, – Ushtar i UÇK-së në brigadën 342, Zona operative e Shalës, i cili ra në altarin e lirisë më 14.06.1999 në Begunc – Viti, për kontribut të çmuar në çlirimin e Kosovës,
- . Ilaz Kolla (post mortum), Bashkëlufëtare në brigadën e Shaban Palluzhës, për kontributin e dhënë në pajtimin e gjaqeve dhe ngatërresave.
- . Aziz Bici, Komandant i UÇK së, për kontribut të jashtëzakonshëm në luftë për çlirimin e Kosovës.
- . Qazim Uka, Për kontribut të jashtëzakonshëm në luftë për lirinë e Kosovës.

Me Mirënjohje nderohen:

- . Skender Kapiti, Për kontributin e tij në ngritjen e qendrës për mobilizimin dhe sistemimin e vullnetarëve nga diaspora, për çlirimin e Kosovës.
- . SHOQATA “KOSOVA – SHKUPI” Kryetar – Rexhep Gyndyz, Bursa - Turqi
Për kontributin e tij në vurjen e kontakteve dhe afrimin e shqiptarëve nga Turqia me shqiptarët në vendet tjera të rajonit dhe më gjerë
- Fahredin Gynler, Për kontributin e tij në trajnimin dhe aftësimin e nxënësve të shkollave të mesme të Vushtrrisë
- . Ilir Izroku, mësimdhënës i edukatës fizike në SHMU-1, për suksese me nxënës në nivel vendi dhe për performancë si futbollist aktiv në superligën e Kosovës.
- . Lirie Ferizi, zyrtare për arsimin në DKA, për rezultatet e dëshmuara në fushën e arsimit.
- . Agron Gërxhaliu, Maturant në Gjimnazin “Eqrem Çabej ” Vushtrri, për suksese shembullore të treguar në mësim.
- . Amire Hyseni, Maturante në Gjimnazin “Eqrem Çabej” Vushtrri për rezultate të dalluara në mësim dhe aktivitete shkollore.
- . NNP “Nuhi Ujkani”, për suksese të arritura në zhvillimin e kapaciteteve prodhuese.
- . SH.P.K Agrovin – Ramadan Kasumi, për rezultatet të dalluara në kultivimin e patates.
- . Firma: DPZ “Bunjaku” Vushtrri, për punë të suksesshme si metal gdhendës, dhe për ofrimin e mundësisë për zhvillimin e praktikës pa pagesë për nxënësit e SHMT “Lutfi Musiqi” në Vushtrri.
- . Nesim Ispahiu, për kontributin e tij në fushën e artit.
- . Fazli Rashica, për kontributin e tij afirmativ në lëmin e muzikës.
- . Klubi i Basketbollit “Vushtrria Basket” për të arriturat e dëshmuara në basketboll.
- . Nimon Ferizi, (post mortum) për aktivitetin e dalluara për çështje kombëtare, pjesëmarrës në Demonstratat e vitit 1981, si dhe pjesëtar i UÇK-së.
- . Jahja (Rrahim) Mehmeti- për kontributin e tij si ushtar i dalluar i UÇK-së, dhe i plagosur në luftë.
- . Sebahate Braha, për rezultate të dalluara në punë në administratën komunale.
- . Mexhit (Hashim) Bunjaku, Bashkatdhetar i ynë nga Norvegjia- për kontributin e tij në dhënien e donacioneve për Komunën e Vushtrrisë.
- 1.2.17. Hysen Hyseni- veteran i UÇK-së, për kontributin e dhënë në luftën e UÇK-së.
- 1.2.18. Bahri Bivolaku, veprimtar i dalluar.

LISTA PËR DEKORATA E MIRËNJOHJE
17.06.2015 DITA E ÇLIRIMIT TË VUSHTRISË

Me Çmimin Qytetar Nderi i Vushtrrisë shpallet Harald Niklason dhe Lena Peterson çmimin e ndan Kryetari i Komunës Bajram Mulaku në Seancën e Kuvendit 29.05.2015.

1. Çmimi “Qytetar Nderi” Selatin Novosella nga Komuna e Prishtinës, për kontributin e tij për çështjen kombëtare.
2. Çmimi “Nderi i Qytetit” Xhafer Istrefi(post mortum) nga Komuna e Vushtrrisë, për kontributin dhe sakrificën e dhënë për çështjen kombëtare.
3. Çmimi “Pena e Artë” Bedri Tahiri nga Komuna e Vushtrrisë për merita të veçanta në fushën e krijimtarisë letrare.

Mirënjohje:

1. Nazif Shala (post mortum) i ndjekur politik, iniciator për formimin e Këshillit për grumbullimin e mjeteve materiale për punëtorët e arsimit në Vushtri.
2. Avni Rashica (post mortum) anëtar i Këshillit për grumbullimin e mjeteve materiale për punëtorët e arsimit në Vushtri.
3. Mensur Kasumi për kontribut të çmuar në luftën e fundit për çlirim në Zonën Operative të Shalës.
4. Rifat Derguti zejtari i vjetër Vushtrrias.
5. Fatime Haziri për kontributin e çmuar për familjet me gjendje të rëndë sociale.
6. Organizata “Tika” për kontributin e dhënë në mënyrë të vazhdueshme që nga paslufta në sektorin e shëndetësisë, bujqësisë dhe arsimit.
7. Bekim Krasniqi për kontributin e tij si ushtar i dalluar i UÇK-së në Zonën Operative të Shalës.
8. Arber Igrishta nxënës i dalluar përfaqësues i Kosovës në garat e matematikës.
9. Bedri Xhema për kontributin e tij të dalluar në lëmin e trashëgimisë kulturore.
10. Remzije Zekolli punëtore e dalluar në Administratën komunale të Vushtrrisë.

MIRËNJOHJET E NDARA PËR NDER TË 17 QESHORIT, DITËS SË ÇLIRIMIT
2016

1. SHMU 1 – Fitues në kuizin “ Champion Kuiz”, i cili organizohet në nivel të Republikës së Kosovës
2. Dr. Ahmet Ademi – Kardiolog, për kontributin e tij për ushtarët e UÇK- së gjatë luftës në Kosovë.
3. Dr. Ramadan Gjoni - Pediatër , për kontributin në fushën e shëndetësisë dhe aktivitetet në shoqatën “Nënë Tereza” në Vushtrri
4. Naxhije Maloku – për kontribut të dalluar në ofrimin e ndihmës (strehimit) për qytetarët e Komunës së Vushtrrisë para dhe gjatë luftës në Kosovë
5. Nezir Klinaku – Veteran i UÇK- së, për kontribut të çmuar për çlirimin e Kosovës, Brigada 142 e Zonës Operative të Shalës.
6. Sabri Behrami – Post Mortum, veteran I UÇK- së si dhe punëtor I dalluar në administratën komunale në Vushtrri
7. Idriz Muzaqi – për kontributin e tij profesional si zyrtar ligjor si dhe mbrojtjen e interesave të Komunës
8. Dr. Agim Bregaj – Radiolog, për kontributin e tij në lëmin e shëndetësis dhënë Batalionit IV të Brigadës 141 “Mehë Uka”
9. Bahrije Pllana, për kontributin e dhënë ne fushën e arsimit, aktiviste dhe mësimdhënëse e dalluar
10. Ismet Shaqiri, për kontributin e dhënë në lëmin e shëndetësis në Brigadën 141 “Mehë Uka”

PËR NDER TË „DITËS SË ÇLIRIMIT TË VUSHTRISË”, MË 17 QERSHOR 2017
NDEROHEN ME MIRËNJOHJE: 2017

- 2. Ismet Kurti, postmortum, veteran i luftës së UÇK-së;**
- 3. Sylva Hasani, veteran i luftës së UÇK-së;**
- 4. Safet Hasani, invalid i luftës së UÇK-së;**
- 5. Bejtush Beqiri, invalid i luftës së UÇK-së;**
- 6. Ramadan Ademi, veprimtar i shquar, prind i dëshmorit dhe i martirit;**
- 7. Beqir Fazliu, veprimtar i shquar, prind i dëshmorit;**
- 8. Sadik Hasani, i burgosur politik;**
- 9. Jakup Shyti, i burgosur politik;**
- 10. Mahmut Sylva, veprimtar, udhëheqës i shoqatës të martirëve;**
- 11. Abaz Shyti, për kontribut për çështjen kombëtare, veteran i luftës së UÇK-së;**
- 12. Selvete Sholla, për kontributin e dhënë në fushën e arsimit, aktiviste dhe veterane e arsimit;**
- 13. Titulli “Nderi i qytetit” i ndahet gjeneral Rrahman Ramës, ish-komandant i Zonës Operative të Shalës i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.**

VENDIM
PËR NDARJE TË MIRËNJOHJEVE PËR NDER TË 17 QERSHORIT DITËS SË
ÇLIRIMIT 2018

1. Me këtë vendim, për nder të Ditës së Çlirimit të Vushtrrisë, më 17 qershor 2018 nderohen me mirënjohje :

1. Mustafë Venhari (post mortum) – veprimtar i çështjes kombëtare;
2. Bahtir Haradinaj – ish I burgosur politik, veprimtar i çështjes kombëtare;
3. Jakup Krasniqi – veteran I arsimit, ish drejtor komunal I arsimit;
4. Jakup Muzaqi – për kontributin e tij në fushën e kulturës dhe arsimit;
5. Halim Selaci – për kontributin e tij në fushën e kulturës dhe arsimit;
6. Muhamed Alidema – për kontributin në fushën e sigurisë dhe bashkëpunimin ndërinstytucional me komunën. Zyrtarë policorë nga gjenerata e pare e Policisë së Kosovës, aktualisht komandant I Stacionit Policorë në Vushtrri;
7. Familja e Hajrullah Shalës – për kontributin në fushën e arsimit, ndërtimin e shkollës në fshatin Akrashticë;
8. Sedat Islami, për kontributin e tij në fushën e edukimit fetar;
9. Pranvera Hyseni – studente e dalluar;
10. Edi Mehana – për arritje në fushën e artit;

VENDIM
PËR NDARJE TË MIRËNJOHJEVE PËR NDER TË 17 QERSHORIT "DITËS SË
ÇLIRIMIT" 2019

1. Me këtë vendim, për nder të Ditës së Çlirimit të Vushtrrisë, më 17 qershor 2019 nderohen me mirënjohje :

1.1 SHefqet Karakashi (post mortum) – për kontributin e dhënë në fushën e arsimit;

1.2 Dr. Sc. Jusuf S. Vatovci – veteran I arsimit, për kontributin e dhënë në shkencë;

1.3 Avni Smi Imeri – për kontributin e dhënë në luftën e UÇK-së (veteran I luftës);

1.4 Ramë Hysen Gashi, (post mortum) – ish I burgosur politik, veprimtar i çështjes kombëtare;

1.5 Isa Behram Sherifi, për kontributin e dhënë në luftën e UÇK – së (invalid I luftës);

1.6 Hamdi Pronaj, për kontributin e dhënë gjatë viteve të 90-ta në fushën e arsimit;

1.7 Valdet Uka, për kontributin e dhënë në lëmin e shëndetësisë;

1.8 Qenan Çerkezi, për kontributin e dhënë në artizanat;

1.9 Ilmi Hyseni Saraçi, për kontributin e tij në luftëra në trojet shqiptare, ku në luftën e Kosovës është I plagosur;

1.10 Xhafer Haradinaj, për kontributin e dhënë në lëmin e bujqësisë;

Çmimi "NDERI I QYTETIT" – Ali Januzi nga Komuna e Vushtrrisë i ndahet çmimi "Nderi i qytetit", për kontributin e dhënë si veprimtar i çështjes kombëtare, pjesëmarrës në demonstratat e vitit 1981, si dhe për kontributin e çmuar në luftën për çlirimin e Kosovës.

Çmimi "PENA E ARTË" – Remzije Zekolli nga Komuna e Vushtrrisë i ndahet çmimi "Pena e Artë", për kontributin e dhënë në fushën e letërsisë, si autore e disa librave në fushën e letërsisë, publicistikës dhe kritikës letrare.

VENDIM
PËR NDARJE TË MIRËNJOHJEVE PËR NDER TË 17 QERSHORIT "DITËS SË
CLIRIMIT" VITI 2020

1. Hasan Shkreli – prind i dy martirëve të lirisë Rrahim e Bukurie Shkreli
 2. Shukri Adem- Kalludra për kontributin e dhënë për çlirimin për çlirimin e vendit veteran i UÇK-së
 3. Xhevat Imeri prind i dëshmorit Nezir Imeri heroit të Kosovës
 4. Riza Ibra (post mortum) ish luftëtar i UÇK-së
 5. Bekë Shyti për kontributin e dhënë në fushën e shëndetësisë specialist i mjekësisë familjare
 6. Fahrije Kllokoqi për kontributin e dhënë në fushën e letërsisë poetë e dalluar
 7. Izet Morina për kontributin e dhënë në lëmin e arsimit mësimdhënës i dalluar
 8. Natyra Badivuku Kajtazi mësimdhënëse dhe humaniste
 9. Fatmir Aliu veteran i UÇK-së
 10. Rifat Mustafa për kontributin e dhënë në fushën e arsimit dhe kontribut të çmuar në luftën e UÇK-së
- z. Idriz Asllani çmimi “Nderi i Qytetit” për kontributin e dhënë si veprimtar i çështjes kombëtare pjesëmarrës në demonstratat e vitit 1988.

Stafit të Kujdesit parësor Shëndetësor në Komunën e Vushtrrisë iu ndahet titulli “Nderi i Qytetit” për kontributin e dëshmuar angazhim dhe përkushtim për punën e tyre në luftën kundër pandemisë corona virus covid -19.

z.Halil Kastrati drejtor i Shoqatës Bamirëse “Jetimat e Ballkanit i ndahet titulli “Qytetar Nderi” i Komunës së Vushtrrisë për kontributin e madh në aspektin e humanizmit në ndërtimin e çështjeve të banimit.

z. Jan Braathu shef i Misionit të OSBE-së i ndahet titulli “Qytetar Nderi” për kontributin e realizimit të projektit të sistemit të adresave të rrugëve.

VENDIM
PËR NDARJE TË MIRËNJOHJEVE PËR NDER TË 17 QERSHORIT "DITËS SË
ÇLIRIMIT" VITI 2021

1. AQH (Accessible Quality Healthcare) Kujdesi Shëndetësor i Qasshëm dhe Cilësor për kontributin e dhënë në fushën e shëndetësisë.
 2. Hajzer Beqiri- (pas vdekjes) për kontributin e dhënë për çështjen kombëtare, babi i heroit Batri Beqiri
 3. Lulëzim Krasniqi (pas vdekjes) për kontributin e dhënë si luftëtar i UÇK-së
 4. Besim Shyti për kontributin e dhënë si veteran i luftës së UÇK-së
 5. Hajrullah Saraçi (pas vdekjes) për kontributin e dhënë si mjek, ish drejtor i Spitalit në Vushtrri
 6. Mihane Kadriu për sakrificën e familjes e cila në luftën për çlirim humbi bashkëshortin dhe dy djemët
 7. Jakup Neziri (pas vdekjes) për kontributin e dhënë në fushën e arsimit
 8. Shaip Azemi (pas vdekjes) për kontributin e dhënë si ish punëtor i arsimit
 9. Nebahate Zahiti (pas vdekjes) për kontributin e dhënë si infermiere në QKMF
 10. Ferat Isufi (pas vdekjes) punëtor teknik në QKMF
 11. Jusuf Haradinaj (pas vdekjes) për kontributin e dhënë në fushën e arsimit
 12. Shaqir Musliu (pas vdekjes) për kontributin e dhënë si veteran në luftën e UÇK-së
 13. Ferki Rashica (pas vdekjes) për kontributin e dhënë për klubin e futbollit “Kosova e Vushtrrisë”
 14. Zenel Bunjaku për kontributin e dhënë në zhvillimin e ekonomisë së vogël dhe bujqësisë
 15. Flora Shabani për kontributin e dhënë në biznese dhe për bashkëpunim shembullor me grupin e grave Asambliste të Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë
 16. Bahridin Tahiri ish pjesëtar i UÇK-së dhe zyrtar policorë, për kontributin e dhënë në reagimin profesional në shuarjen e zjarrit në Spitalin “Sheikh Zayed” në Vushtrri
 17. Ajmane Ferati për kontributin e dhënë në administratën e Komunës, familjare e martirit
 18. Sadik Haliti për kontributin e dhënë në luftën për çlirim invalid i UÇK-së
 19. Metije Gërxhaliu për shërbim të pa kursyer në përgatitje të ushqimit për ushtarët e UÇK-së e cila në luftë humbi burrin dhe djalin
 20. Fikrije Badivuku Hoti për kontributin e dhënë në fushën e arsimit
 21. Fatime Jashari Shaqiri për kontributin e dhënë në demonstratat e vitit 1989 për aktivizim të dalluar qytetar kundër okupatorit serbë
 22. Zoja Shaqiri për kontributin e dhënë në demonstratat e vitit 1989 për aktivizim të dalluar qytetar kundër okupatorit serbë
 23. Rahime Hajrizi Hasani për kontributin e dhënë në demonstratat e vitit 1989 për aktivizim të dalluar qytetar kundër okupatorit serbë
 24. Luljeta Salihu për kontributin e dhënë në demonstratat e vitit 1989 për aktivizim të dalluar qytetar kundër okupatorit serbë
- z. Bajram Mulaku i ndahet titulli “Nderi i qytetit” për kontributin e dhënë për Vushtrrinë si intelektual dhe si ish Kryetar i Komunës së Vushtrrisë.**
- z. Enver Oruçaj ish komandant i Brigadës 142 të Zonës Operative të Shalës të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës i ndahet titulli “Qytetar Nderi” i Komunës së Vushtrrisë.**



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA



KOMUNA VUSHTRRI
OPŠTINA VUČITRN

PËR/ZA/TO:	KPF-në dhe Kuvendin e Komunës së Vushtrrisë
Propozues dhe Hartues:	Komisioni për Hartimin e Rregullores z. Ilmi Azemi, kryesues i komisionit z. Shkelzen Xhaferi, anëtar i komisionit; z. Sylejman Mehulli, anëtar i komisionit; z. Ismet Gashi, anëtar i komisionit dhe z. Bastri Duraku, anëtar i komisionit
PËRMES/PREKO/THROUGH:	Sekretarisë së kuvendit
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Akt - përcjellës

Të nderuar anëtarë të KPF-së/kuvendit,

Në shtojcë të këtij akti përcjellës gjeni të bashkangjitur Draft- Rregulloren për Punën e Komiteteve dhe Komisioneve të Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë, e cila i është nënshtruar diskutimit publik, gjatë kohës sa ky akt ishte në diskutim dhe shqyrtim publik nuk kemi pranuar ndonjë koment, propozim apo vërejtje.

I propozojmë Komitetit për Politikë dhe Financa që ta shqyrtoj këtë dokument dhe të një njëjtin ta procedoj për aprovim në kuvend.

Me respekt!

Bazuar në nenin 12, paragrafi 2, shkronja “c”, në lidhje me nenin 51 paragrafi 1,2 dhe 3 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, si dhe Udhëzimin Administrativ (MPL) nr.05/2020 për procedurën e themelimit, përbërjen dhe kompetencat e komiteteve të përhershme dhe komiteteve tjera në Komunë, nenit 19, pika 1.3 të Statutit të Komunës së Vushtrrisë, Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë në mbledhjen e mbajtur më _____ 2023 aprovon këtë:

DRAFT- RREGULLORE
PËR PUNËN E KOMITETEVE DHE KOMISIONEVE TË KUVENDIT TË KOMUNËS
SË VUSHTRRISË

I. DISPOZITA E PËRGJITHSHME

Neni 1

Qëllimi

Me këtë rregullore përcaktohen, kompetencat, aktivitetet, mënyra e punës së komiteteve dhe komisioneve të themeluara nga Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë, duke u bazuar në Ligjin për Vetëqeverisje Lokal, Udhëzimet Administrative që rregullojnë këtë fushë, si dhe Statutit të Komunës.

Neni 2

Përkufizimet

1. Çdo herë kur në këtë Rregullore përdoren, termat vijuese kanë kuptimin e përcaktuar më poshtë, përveç rasteve kur konteksti ku paraqitet termi i tillë tregon qartë se ka kuptim tjetër:

1.1 “Ligj” nënkupton Ligjin për Vetëqeverisje Lokale nr. 03/L-040 të datës 20.02.2008

1.2 “Statut” nënkupton Statutin e Komunës së Vushtrrisë

1.3 “Kuvendi i Komunës”, nënkupton Kuvendin e Komunës së Vushtrrisë,

1.4 “Komitet”, nënkupton Komitetet e formuara nga Kuvendi i Komunës.

1.5 “Shërbimi Profesional për Punët e Kuvendit”, nënkupton shërbimin përkatës që ofron shërbime profesionale, juridike dhe teknike për komitetet e Kuvendit të Komunës. (Sekretaria e Kuvendit).

II. PËRBËRJA, KOMPETENCAT DHE AKTIVITETET E KOMITETEVE

Neni 3

Nocioni i Komiteteve

1. Komitetet janë trupa ndihmës të Kuvendit të Komunës dhe punojnë për dhe në emër të Kuvendit të Komunës. Roli i tyre është që të lehtësojnë punën e Kuvendit të Komunës në lidhje me procesin e marrjes së vendimeve, që lidhen me çështje të caktuara, duke trajtuar, hartuar, propozuar çështje me interes të përgjithshëm dhe në këtë mënyrë do të plotësohet një vakuim i cili i ka munguar aktivizmit Kuvendar.
2. Shumë çështje jetike të cilat presin zgjidhje dhe ballafaqohet komuna në të shumtën e rasteve i takojnë natyrës teknike që kërkojnë angazhimin e ekspertëve që janë anëtar të Kuvendit, por që shërbejnë si anëtarë të Komiteteve relevante. Prandaj, komitetet kanë rolin që të ndihmojnë Kuvendin në kursimin e kohës dhe përpjekjeve duke i ofruar Komitetit për Politikë dhe Financa dhe Kuvendit ekspertizën politike, juridike, financiare, teknike, rekomandime, konsultime dhe angazhim në çështje specifike.
3. Komitete tjera të kuvendit gjatë aktivitetit të tyre do të mbajnë, 6 mbledhje në vit.
4. Shumica e anëtarëve të Komiteteve, (pos Komiteteve Konsultative) do të jenë anëtar të Kuvendit të Komunës. Anëtarët e Komiteteve do të reflektojnë sa më shumë që është e mundur me proporcionin e vendeve që kanë partitë politike në Kuvendin e Komunës.

Neni 4

Kompetencat e përgjithshme dhe rolet e Komiteteve

1. Komitetet mund të propozojnë prioritetet e buxhetit Brenda një fushe të caktuar në mënyrë që të drejtohen në Komitetin për Politikë dhe Financa dhe pasi të rekomandohen nga Komiteti për Politikë dhe Financa të dërgohen për aprovim në Kuvendin Komunal.
2. Komitetet do të shqyrtojnë në vazhdimësi aktivitetet dhe zbatimin e rregulloreve tek drejtoritë përkatëse (planet e punës, raportet mujore dhe vjetore, informatat, raportet mbi vlerësimin etj.) si dhe formimin e propozimeve hartimin e propozimeve për Kryetarin e Komunës me çka do të ndihmohet përmirësimi i kryerjes së punëve nga drejtoritë.
3. Komitetet do të rekomandojnë në përgatitjen dhe hartimin e vendimeve të Kuvendit të Komunës që i referohen një fushe të caktuar të aktiviteteve brenda përgjegjësisë të Komitetit.
4. Të gjithë anëtarët e komiteteve konform dispozitave të statutit të komunës, do të marrin kompensim financiar për pjesëmarrje në punën e komiteteve komunale. Kryesuesi i komitetit do të jetë përgjegjës për koordinimin e punës së komitetit komunal si dhe të përgatis orarin e mbledhjeve ad-hoc, të udhëheq listën e pjesëmarrësve, të sigurojë procedurat e kompensimit të anëtarëve të komitetit, informatat mbi vlerësimin individual të kryerjes së punëve nga anëtarët dhe të paraqes raport për punën e komitetit së paku një herë në vit.

5. Administrata komunale (sekretaria e kuvendit) do të ofrojë mbështetje të nevojshme logjistike dhe administrative për kryerjen e punëve me sukses të komiteteve duke përfshirë shpërndarjen e materialeve për mbledhje sipas nevojës, vendtakimet, procesmbajtësin, vendosjen në dosje të procesverbaleve dhe materialet e tjera të komiteteve.

Neni 5 **Formimi i komiteteve**

1. Konform dispozitave të nenit 36 të Statutit të Komunës së Vushtrrisë formohen dy komitete të përhershme;

1.1. Komiteti për Politikë dhe Financa, dhe

1.2. Komiteti për Komunitete.

2. Konform dispozitave të Statutit të Komunës së Vushtrrisë, Kuvendi i Komunës formon komitete tjera:

2.1. Komiteti për Arsim dhe Kulturë

2.2. Komiteti për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale

2.3. Komiteti për Planifikim Urban, Mbrojtje të ambientit, shërbime publike dhe emergjenca

2.4. Komiteti për Zhvillim ekonomik, bujqësi dhe zhvillim rural

2.5. Komiteti për barazi gjinore, të drejta të njeriut dhe komunitete.

Neni 6 **Komiteti për Arsim dhe Kulturë**

1. Komiteti për Arsim dhe Kulturë përbëhet nga 5 anëtarë që duhet të reflektoj në kuotën gjinore.

1.1. Kompetencat e këtij Komiteti janë:

1.1.1 Të shqyrtojë rregullat për arsim dhe kulturë,

1.1.2. Të këshilloj dhe konsultohet me Drejtoritë Respektive,

1.1.3. Të përgatis draft-rregullore, propozim-vendime dhe dokumente tjera të nevojshme lidhur me zbatimin e politikave të ndryshme në interes të përgjithshëm të arsimit dhe kulturës, të njëjtat procedohen në Komitetin për Politikë dhe Financa.

1.1.4. Të dëgjoj apelet nga nxënësit në lidhje me kualitetin e mësimin dhe masave disiplinore,

1.1.5. Të propozoj dhe mbështes raportin shkollë-shoqëri në mes të shkollave dhe shoqërisë përreth me institucione publike dhe private të cilat merren me arsimimin e personave,

1.1.6. Të parashikoj dhe vlerësoj nevojat arsimore të komunës në të ardhmen,

1.1.7. Të përcaktoj prioritetet globale për qytetin në sferën e arsimit dhe kulturës,

1.7.8. Të paraqes dhe rekomandoj për diskutim buxhetor ngjarjet e rregullta dhe të rëndësishme, festivalet e kampionatet.

Neni 7

Komiteti për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale

1. Komiteti për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale përbëhet nga 5 anëtarë që duhet të reflektoj në kuotën gjinore.

2. Kompetencat e këtij komiteti janë:

2.1. Të monitoroj implementimin e shërbimeve për kujdesin primar shëndetësor në Komunë.

2.2. Komiteti do të përfaqësohet në Këshillin Drejtues të QKMF-së në cilësinë e monitoruesit/vëzhguesit.

2.3. Shqyrton projekt-buxhetin për shëndetësi dhe jep propozime për Komitetin për Politikë dhe Financa.

2.4. Shqyrton planin vjetor të punës të përgatitur nga Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenie Sociale.

2.5. Monitoron zbatimin e dispozitave në lidhje me rastet sociale, kategorive të dala nga lufta të UÇK-së, viktimave të dhunës në familje, fëmijë të mitur, të pastrehëve, të rikthyerëve dhe pensionistëve.

2.6. Të këshilloj dhe konsultohet me drejtorinë e shëndetësisë dhe mirëqenies sociale.

2.7. Të ndihmoj për caktimin e fondeve për strehim, në pajtim me Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale.

2.8. Të ndihmoj në formulimin e propozimeve për strategjinë e strehimit duke përfshirë mbulimin e qirave për të pastrehët dhe prioritetet përkatëse për renovime të ndërtimeve dhe ndihmën financiare.

2.9. Ndhmon në Mbikëqyrjen të situatës epidemiologjike në nivel komunal.

2.10. Ndhmon në monitorimin e masave mbrojtëse shëndetësore që kanë të bëjnë me sigurimin e ujit të pijshëm dhe aktiviteteteve të DDD-së (Dezinfektim, Deratezim, Dezinsektim).

Neni 8

Komiteti për Planifikim Urban, Mbrojtje të ambientit, shërbime publike dhe emergjenca

1. Komiteti përbëhet prej 5 anëtarëve, duke përfshirë edhe kuotën gjinore.
2. Kompetencat e këtij Komiteti janë:
 - 2.1. Të këshilloj dhe konsultohet me Drejtoritë respektive;
 - 2.2. Inicimi i programeve dhe projekteve komunale;
 - 2.3. Të përcjellë zbatimin e planit zhvillimor komunal (PZHK);
 - 2.4. Të përcjellë të gjitha çështjet lidhur me ndërtimin;
 - 2.4. Të kontrollojë procedurat për vendosjen e kiosqeve;
 - 2.5. Të kontrollojë procedurat për reklama;
 - 2.6. Të kontrollojë procedurat për zbatimin e planifikimit;
 - 2.7. Të ushtroj mbrojtjen dhe kontrollin e ndërtesave në interes arkitektonik apo historik;
 - 2.8. Të ndihmoj dhe ruan ambientin;
 - 2.9. Parandalimi i ndotjes së ambientit, ajrit, tokës dhe ujit;
 - 2.10. Të mbështes zhvillim e ardhshëm të komunës, sidomos në lidhje me mbrojtjen e tokës bujqësore;
 - 2.11. Shqyrton dhe propozon politika dhe dokumente tjera të nevojshme;
 - 2.12. Përmes bordeve të ndërmarrjeve komunale, monitoron dhe vlerëson efikasitetin e metodave dhe procedurave për ofrimin e shërbimeve, përshtat nivelin e shërbimit dhe stafit.

Neni 9

Komiteti për Zhvillim ekonomik, bujqësi dhe zhvillim rural

1. Komiteti për Zhvillim ekonomik, bujqësi dhe zhvillim rural përbëhet prej 5 anëtarëve, duke përfshirë edhe kuotën gjinore.
 - 1.1. Kompetencat e këtij komiteti janë:
 - 1.2. Të këshilloj dhe të konsultohet me drejtoritë përkatëse.
 - 1.3. Të inicioj programet dhe projektet zhvillimore komunale.
 - 1.4. Përcjellë aktivitetet në fushën e zhvillimit ekonomik, të bujqësisë dhe zhvillimit rural.

1.5. Kontribuon në krijimin e kushteve të qëndrueshme për zhvillimin e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme.

1.6. Përgatitja e planeve konkrete për zhvillim e bujqësisë.

1.7. Merr pjesë në Projekt hartimin e planit për zhvillim të qëndrueshëm ekonomik të komunës.

1.8. Rekomandon plane konkrete për zhvillimin e ekonomisë.

1.9. Shqyrtimi i çështjes në lidhje me transportin publik.

Neni 10

Komiteti për barazi gjinore, të drejta të njeriut dhe komunitete

1.1. Komiteti për barazi gjinore, të drejta të njeriut dhe komunitete përbëhet nga 5 anëtarë, duke përfshirë kuotën gjinore.

2. Kompetencat e këtij komiteti janë:

2.1. Mbikëqyr realizimin e të drejtave të barabarta, të drejtave civile, politike, ekonomike dhe kulturore të komuniteteve.

2.2. Krijimi i kushteve për kthim dhe integrim të qëndrueshëm të refugjatëve, të kthyerve, personave të zhvendosur dhe atyre të riatdhesuar.

2.3. Të mbikëqyr aktet, vendimet, në të cilat parashihet respektimi i kuotës gjinore.

2.4. Parandalimi i çfarëdo forme të diskriminimit të qytetarëve, që ndërlidhet me orientimin kombëtar, etnik, fetar, politik, racor, kulturor.

Neni 11

Formimi i Komisioneve nga Kuvendi, kompensimi i Komisioneve Kuvendare dhe Shërbimit Profesional (Sekretaria e Kuvendit).

1. Kuvendi komunal formon komisione ad-hoc, si dhe komisione kuvendare tjera me qëllim dhe për nevoja të përmbushjes me sukses të objektivave të caktuara gjatë periudhave të caktuara.

2. Kuvendi komunal me rastin e formimit të komisionit gjegjës, çdo herë dhe në çdo vendim përcakton fushëveprimin, kompetencat, përgjegjësitë dhe natyrën e punës së komisionit.

3. Kompensimi i Komisioneve Kuvendare dhe Shërbimit Profesional (sekretaria e kuvendit), komisionet kuvendare dhe sekretaria e kuvendit do të kompensohen për pjesëmarrjen në komisione si në vijim:

3.1. Çdo anëtarë i komisionit kuvendar si dhe anëtari i sekretarisë së kuvendit do të kompensohet në vlerën prej 50 eurove për çdo takim punues sipas vendimit të kuvendit.

3.2. Për çdo vendim të marrë nga Kuvendi Komunal, maksimum do të paguhen tri takime punuese të komisioneve respektive.

3.3. Kryesuesi i komisionit është përgjegjës për dorëzimin e procesverbaleve të takimeve të mbajtura në sekretarinë e kuvendit.

3.4. Sekretaria e Kuvendit obligohet të mbajë evidencën e saktë të takimeve të mbajtura për secilin komision të formuar nga kuvendi , dhe të njëjtat evidence ne formën e shkruar duhet t'i procedojë për pagesa ne departamentet gjegjëse.

Neni 12 **Hyrja në fuqi**

Kjo rregullore hyn në fuqi pesëmbëdhjete (15) ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit të Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal, si dhe shtatë (7) ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

Melihate Basholli-Latifi

Kryesuese e Kuvendit



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVS
KOMUNA VUSHTRRI - OPSHTINA VUCITRN
DREJTORIA PËR EKONOMI, BUJQËSI, PYLLTARI DHE ZHVILLIM
VUSHTRRI



SEKTORI I PYLLTARISË

*Informatë lidhur me gjendjen dhe mbrojtjen e pyjeve në Komunën e
Vushtrrisë për vitin 2022*

Gjatë vitit 2022 në sektorin e pyjeve kemi bërë përpjekje për ruajtjen dhe mbrojtjen e pyjeve dhe resurseve pyjore nga prerësit ilegal dhe dëmtuesve tjerë ku dihet se Komuna jonë disponon me 13218 ha me pyje, ku prej tyre 7322ha janë pyje publike dhe 5896ha pyje private.

-Te hyra nga pyjet private në vitin 2022, 9 fl- pagesa me vlerë prej 615.10€.

-Te hyra nga pyjet publike për vitin 2022 kemi pasur shitje me pakicë edhe janë zhvilluar te gjitha procedurat për shitje te pishat e djegura në Oblovik ku te hyra janë gjithsej 630€. Shitje te druve te konfiskuara gjatë vitit 2022 nuk kemi pasur.

-Numri i fletë-paraqitjeve për vitin 2022 ka qenë 128 copa me 272.25m³, kurse dëmi në euro është 39845.53€.

-Gjatë vitit 2022 kemi bërë 28 konfiskime ne asistim me policin ne sasi prej 55.20m³.

- Sipërfaqe të përfshira nga zjarri gjatë vitit 2022 kemi pasur 65.70ha.

-Gjatë vitit 2022 kërkesa për leje-prerje kemi pasur 31 copë, kurse prej tyre 9 copë janë të kryera me 332.93m³.

Gjatë vitit 2022 (5) pesë terrene i kemi pasur te mbuluara me roje te rregullta, kurse dy terrene tjera te mbuluara me roje te përkohshme. Edhe për kundër te gjitha angazhimeve tona gjendja nuk qenë e kënaqshme sepse kemi dëme te shkaktuara nga zjarret dhe prerësit ilegal.

PUNËT EKRYERA NË PYJE PUBLIKE DHE SHITETRORE

Nr	Përmbajtja	Viti - 2022	Vrejtje
----	------------	-------------	---------

1.	Të hyrat, pyje publike nga shitja	630€			
2.	Raporti i fletë-paraqitjeve në m ³ , shuma në €	128Flp=272.25m ³ = 39845.53€			
3.	Specifikacioni i konfiskimit	28Konf=55.20m ³			
4.	Pyllëzimeve	25 ha Vesekofc			
5.	Zjarreve	65.70-ha			
6.	Shitje në Oblovik	61.30 m ³ =630€			
7.	Kontrolli i terreneve-veshtrimet profesionale	76			
8.	Shitje nga depoja	0€			
9.	Shpërndarje, familjeve skamnore	0m ³	0m ³		
PUNËT E KRYERA NË PYJE PRIVATE					
1.	Kërkesa parashtruara për prerje	31copë			
2.	Të shqyrtuara	9=332.93m ³ . m ³			
3.	Të pa shqyrtuara	22			
4.	Specifikacioni i fletë përcjelljeve në pyje private	22flp =45m ³			
5.	Të hyrat në pyje private	615.10 €			
6.	Gjithsejt te hyra p.private dhe publike	1245.10€			

INFORMATË ME DETALE RRETH SIPËRFAQEVE ME PYJE

1. Sipërfaqet e mbuluara me pyje në komunën tone janë: 13.218 ha

a) pyje publike----- 7.322 ha

b) pyje private----- 5.896 ha

Gjithsejt-----13218ha

2. Pyjet ne komunën tone janë të ndara në 5 zona:

1. Qyqavica I-II-III- Oblovik-----2.000 ha

2. Quka e Skoqnes-----3.400 ha

3. Bukogllava-Vesekovci-----833 ha

4.Sllakovci -----739 ha

5.Gërdeqi -----350 ha

3.Pyje halore -----205 ha

4. Pyje gjethore -----7127 ha

5. Punëtorë të rregullt jemi 7(shtat).

6.Stafi I sektorit të pylltarisë përbëhet nga :

Një përgjegjës, dy teknik dhe katër (5) roje të përhershëm, dy roje i kemi te ngarkuar me nga dy terrene

Drejtori i DEBPZHR. -
Ergin Sunguri

